

KOSOVARJA

Ballina: Lindita Iseni-Emerllahu

Kush nga politikanët tanë ma rrahë shpinën

Dua Lipa krenaria e Kosovës

Burri i martuar me studenten nga Klina


Enca Haxhia sa me dashnor sa beqare

Pse i lashë fëmijët e burrin për

ish-dashnorin

Dikush s'le gjë pa bërë dhe prapë e virgjër!

LINDA
frizerja dhe biznesmenja me 20 diploma





DINO COMPANY

MAGJISTRALJA PRISHTINE-FERIZAJ km-2, 14000 LIPJAN, KOSOVË



+383 44 206 586



www.dino-company.com

Dino keramika, është kompani e cila ofron produkte me shumice dhe pakicë, nje game të gjere të llojeve të keramikës të cilat vijnë nga fabrikat me të njohura italiane dhe spanjolle ; “mirage”, “azuvi”, “ecoceramic”

Strukturë dhe ngjyrë të veçantë, efekte që kënaq shijet dhe nevojat estetike, kombinime të koordinuara, kontraste dhe përshtatje.



NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME

ARMIQ
NDAJ
BAKTERIEVE

NUK
PËRBEJNË
ALERGJI

PASTROHEN
LEHTË

NUK LËSHOJNË
KOMPONENTE
TË DËMSHME



info@brezovicahotel.com
www.brezovicahotel.com



Malda Susuri, *këngëtare, artiste*

Malda Susuri, e lindur në Prizren, më 1988, njihet si këngëtare e afirmuar, por edhe si artiste.

Gjyshi i saj me profesion është piktor dhe kjo ka ndikuar që edhe ajo, krahas këngës, t'i përkushtohet edhe artit.

"Shumë herë i kam kërkuar gjyshit një portret, i ekspozuar edhe në "Ekspoart". Mirëpo, ai nuk ka dashur t'ma dhuroj, se ka menduar të hapë personalisht një ekspozitë dhe që t'ia bashkëngjit punimeve.

Kjo ishte ajo që, kohë më parë, më shtyu të hapi një ekspozitë në 77-vjetorin e lindjes së gjyshit tim. Shumica e veprave

të prezantuara ishin qytete shqiptare, portrete, skica. Dhe, për të realizuar ekspozitën, më është dashur një përkushtim shumë i madh.

Katalogun e kam bërë në bashkëpunim me disa njerëz, e që më kanë ndihmuar shumë. Dhe, nuk mund të quhet vetëm katalog i thjeshtë, sepse përmban një numër të madh të fotografive dhe pikturave. Më shumë do ta quaja katalog voluminoz, që i ngjan një libri", ka shkruar para një kohe Malda Susuri.

Ajo, në të ardhmen e afër, mendon të prezantohet edhe me një tjetër ekspozitë.



Mimoza Shkodra, *këngëtare e kompletuar, por edhe e bukúr*



Mimoza Shkodra, e që jeton sa në Zvicër e sa në Kosovë, është këngëtare me identitet. Stili i saj nuk ngatërrohet lehtë. Ajo me kohë e ka krijuar profilin e saj artistik: është origjinale, e thjeshtë, profesionale, e këndshme. Shkurt e shqip: këngëtare e kompletuar. Të kënduarit "live" është specialiteti i saj dhe e bën me kënaqësi në më të madhe.

Mimoza Shkodra, pronare e hitit "Ndarja", këngë që ka prekur të madh e të vogël, thonë se mund të këndojë gjithçka...

Mimoza sikur i krijon dy karriera njëkohësisht: këndon në ahengje

e dasma dhe, gjithashtu, prezanton këngë e klipe zbavitëse shumë të mira...

"Jam këngëtare dhe puna ime është kënga. Jam në dasma, sepse edhe aty këndohet "live". Pastaj, janë këngët argëtuese, klipet, performancat, të cilat më mbajnë më afër publikut tjetër", thotë ajo.

Në jetën e përditshme duket e thjeshtë, madje më e thjeshtë se në klipe.

Pse?

"Kam stil tim, jam tejet modeste dhe s'më pëlqen të bëj gjëra sa për të rënë në sy".

Linda, frizerja dhe biznesmenja me 20 diploma

Është nga ato gra që nuk i marrin parasysh sfidat, mundimet dhe nuk dorëzohen. Lindita Iseni-Emerllahu, e njohur si Linda, ja del suksesshëm në jetën private si bashkëshorte e nënë, por edhe në atë profesionale, si një nga parukieret më në zë dhe gratë më të fuqishme në biznes. Njihet për punën e shkëlqyer që bën në fushën e parukerisë, për markën e saj të flokëve “Linda hair extensions” dhe shërbimet ekskluzive estetike që ofron në sallonin e saj “Linda coiffure et esthétique”.

Kush është Linda, na e përshkruaj veten?

- Jam 30-vjeçare, e martuar, nënë e tre fëmijëve. Jetoj në Gjenevë të Zvicrës. Jam biznesmene. Them se jam grua e fuqishme, meqë çdo gjë e kam arritur falë përkushtimit dhe angazhimit tim profesional.



Dikur, a mendoje se do të bëheshe kjo që je sot, grua profesioniste dhe e fortë në biznes?

- Qëkur isha fëmijë kam ëndërruar të kem biznesin tim. Kur erdha në Zvicër isha 19 vjeçe dhe nuk dija frëngjisht. Kështu, së pari, fillova ta mësoj gjuhën, në një shkollë ku ishte tejet e vështirë të adaptohem në vend të huaj.

Ndërkohë, linda fëmijën e parë, vajzën. Kisha frikë që në një vend të huaj nuk do të kem ndonjë të ardhme të favorshme. Më pas fillova shkollën për frizere dhe kështu, dalëngadalë, u hapën dyert drejt suksesit.

Sa vështirë dhe sfiduese ka qenë rruga e realizimit profesional, rruga e suksesit?

- Ishte shumë e vështirë, meqë isha në një vend të huaj, ku nuk njihja njeri dhe nuk

flisja gjuhën time.

Në atë kohë, edhe pse e kisha vajzën të vogël, fillova shkollën për flokë, gjë që përbënte një sfidë të dyfishtë. Ndërkohë, dita-ditës më forcohej dëshira për ta realizuar ëndrrën për të pasur biznesin tim.

Fatmirësisht, pas një periudhe, arrita ta përfundoj shkollën dhe të hapi sallonin tim personal, që i ka hapur dyert për klientë qe pesë vjet.

Dhe, kështu, e realizova ëndrrën time...

Kë e ke pasur gjithmonë krah të djathtë?

- Pa dyshim, përherë krah të djathtë e kisha Albanin, bashkëshortin tim, tek i cili gjeja mbështetje dhe forcë.

Po ashtu, më ndihmuan edhe familja ime, e që patën besim në mua dhe më mbështetën pa hamendje.

Të flasim pak për shkollimin tënd në fushën e parukerisë. Ç'thuhet për këtë?

- E dua shumë profesionin tim dhe jam eksperte e ngjyrave. Në Gjenevë jam shumë e kërkuar për ngjyrat bionde, meqë kam edhe markën time të flokëve "Linda hair extensions".

Jeni femër me 20 diploma e certifikata, apo jo?

- Po, i kam 20 diploma e certifikata. Para pak ditësh mora edhe një tjetër certifikatë për laser dhe sapo kam nisur me aplikimin e laserit në sallonin tim.

Ky laser heq qimet pa dëgjie e dhimbje dhe është fjala e fundit e teknologjisë.

Cila është shkolla, trajnimi apo aftësimi më i rëndësishëm që ke marrë gjatë viteve?

- Të gjitha, meqë, përpos flokëve, punoj edhe me thonj, pedikyr, manikyr, depilim, pastrim të fytyrës, mbjelljen e qerpikëve etj.

Mirëpo, më pëlqen shumë kur bëj transformimin e flokëve...

A mund të na tregosh listën e shërbimeve që ofrohen në sallonin tuaj?

- Në sallonin tim afrohet gjithçka që ka të bëjë me flokun, si: prerje, fenerim, shatir, ombre, frizura, minivall,

Linda

Coiffeuse | Esthéticienne | Hair Extensions

A Geneve

NEW Épilation
au Laser à fibre optique des
poils permanent

OFFRE Exceptionnelle pour 10
premières clientes 2500frs
pour tout le corps

contactez nous au

0225257970

au plaisir de
prendre soin de vous !

drejtim të flokëve për 6 muaj etj.

Pastaj, pedikyr, manikyr, mbjelljen e qerpikëve, pastrim fytyre, tatuazh të vetullave, depilim dhe, siç cekam më lart, sapo kemi filluar edhe me laser në sallonin tonë.

Jeni adresa e duhur për porositjen e extensions origjinale. Cilat janë karakteristikat e këtyre flokëve?

- Janë flokë origjinale dhe mund të përdoren nga 1 deri në 2 vjet. Janë flokë ruse, me cilësi shumë të lartë.

Një e famshme që do të doje ta ndryshojë?

- Ka shumë, por Dafina është mjaft e veçantë. Andaj, pse jo?

Cila është jeta jote private?

- Jam e thjeshtë dhe pjesën më të madhe të kohës ia dedikoj familjes, profesionit dhe aktiviteteve sportive.

Diçka pa të cilën nuk mundesh në jetë?

- Pa dyshim, nuk mundem pa familjen time, njerëzit e mi të dashur, por edhe punën e profesionin tim.

Vendi ku gjithmonë shkon me qejf?

- Pa hamendje, në vendlindjen time, në Kosovën tonë të dashur.

Kujt i thua faleminderit?

- Zotit që më ka falë shëndet dhe familje të mrekullueshme, tek e cila mbështetem gjithmonë.

Për fund?

- Të gjitha femrave shqiptare u them se, sado që kanë vështirësi në jetë, asnjëherë të mos dorëzohen në realizimin e ëndrrave të tyre.

Nuk është lehtë, por me besim, punë dhe vullnet arrihet gjithçka...

N. Neziri



Kush i bie tupanit nëpër Prishtinë?

Ka dy-tre vjet që në pjesën e vjetër të qytetit të Prishtinës, aty ku ndodhet Shkolla fillore "Elena Gjika" dhe pjesa kah shtëpia e Nekibe Kelmendit, por edhe gjëkund, verë e dimër, në të nxehtë e në të ftohtë, në shi e borë, veshur me rroba kombëtare, një "sevdali" apo i krisur, i moshës mbi 40 vjeç, i bie tupanit rrugëve e rrugicave dhe nuk ndalet...

Krahas krismave të tupanit, shpeshherë edhe këndon ndonjë këngë, që nuk di as vetë se ç'këndon...

Atë e shoqëron pothuajse gjithmonë një vajzë e re, ndoshta 10 vjeçe, edhe ajo me veshje kombëtare dhe me def në dorë, e që shkon tavolinë më

tavolinë te njerëzit që pinë kafe, që t'i hedhin ndonjë cent.

Sidoqoftë, kam menduar se ai është i fokusuar vetëm në pjesën e vjetër të qytetit të Prishtinës.

Por, jo.

Ditë më parë, teksa ndodhesha në rrugën kryesore të Prishtinës, në afërsi të lokaleve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, tupani dëgjohej nga larg, madje shumë larg.

Dhe, teksa ecja, kur arrita përballë tij, nga krisma e fortë e tupanit barku më dridhej. Vajza me def në dorë veç ndodhej në mesin e mysafirëve që pinin kafe, duke kërkuar që t'i hedhin në def ndonjë cent.

Eh, thash me vete, ky po u gjendka kudo nëpër Prishtinë, e jo vetëm në pjesën e vjetër të Prishtinës!

Thënë të drejtën, këtë herë më bëri nervoz krisma e fort e tupanit dhe zëri i tij teksa këndonte pa lidhje...

Dhe, vetes i thash:

Kush është ky i krisur?

Nga është?

Pse organet e rendit dhe të sigurisë e lejojnë të bëjë zhurmë nëpër qytet, të prishë qetësinë publike?

Sidoqoftë, nga pamja dhe veshja të jep të kuptosh se është nga rrethi i Opojës a Dragashit apo edhe rrethi i Kukësit.

Selim Rama

Pronar dhe botues:
Gani DILIRedaktor përgjegjës:
Isa ILAZIMenaxher:
Driton DILIRedaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita DiliDizajni:
Labinot BërbatovciAdresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.comMarketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

KUSH NGA POLITIKANËT TANË MA RRAHË SHPINËN?

Një ditë para zgjedhjeve lokale...
Dy vetë, të një partie, gjatë ndejës së
rastësishme më thonë: "E dimë, krizë është
dhe për mediumet e shkruara, por ti po e
vazhdon botimin e revistës edhe online,
e cila ka përcjellë gjithë ecjen tonë nëpër
periudha të ndryshme..."

Po tash edhe me Portal po dini t'i përvetë-
soni lexuesit, opinionin... Keni mundësi
me u mëshu të tjerëve dhe me na ndihmu
neve..."

"Fol, çka mund të bëjmë për ty?"

"Kosovarja" gjithmonë na ka përkrahur, na
ka mbështetur", më thotë njëri, të cilin nuk
e kisha pa kaherë, përveç në ekranet tona
televizive.

I dyti, duke m'i rrahur supet:

"Veç ti ke ditë, ke mundur ta mbash re-
vistën deri tash, pa u lakuar asnjëherë! Hal-
lall u qoftë juve të "Kosovares" se asnjëherë
s'jeni shitur për asnjë parti!"

O Zot, ku ishin këta deri dje? Mirë që
m'kishin pa "andërr" dhe u jam kujtua
se bashkë me revistën ende jam gjallë,
përkundër vështirësive të mëdha eko-
nomike për gazetatat e revistat.

E vërtetë, siç tha njëri nga këta partiak,
nuk jemi "shitur", pavarësisht nga valët e
kohës, të jetës, që rrodhën e i përjetuam.
Krenohemi që kemi qenë e po jemi të të
gjithëve, për të gjithë lexuesit tanë, të cilët
na lexojnë...

Ju faleminderit!

*

"Sen s'po marrë vesh. Unë mujta me u
kujdes për 6 fëmijë që i kam, e këta 6 s'po
mujn me u kujdes sot për mue!", janë këto
fjalë të plakës 77-vjeçare, Selvijes, e cila
habitet me kohën çfarë ka ardhur për të
ekzistuar, për të jetuar...

E habitë më shumë fakti se qysh ndodh
kjo, tash, kur e kemi shtetin tonë...

*

Edhe diçka: mbi 50 mijë të rinj kosovarë
çdo vit i mbushin 18 vjet. Moshë mesatare
e popullatës që në Kosovë është rreth
23 vjeç, është lakmi për shumë shtete të
botës...

E për ne?

Gani Dili

Ku mbetën krismat në shtëpinë e braktisur në Bradash të Podujevës?

Kanë shkuar shumë kameramanë të shohin e binden, nëse në një shtëpi të braktisur në fshatin Bradash ndihet një gërhitje e njeriut të padukshëm që fle aty, por nuk shihet...

Në pranverën e vitit 2004, këtë shtëpi e kanë vizituar shumë njerëz e medie, që ta shuajnë kureshtjen me diçka më mistike se jeta e përditshme. Në shtëpinë trekatëshe, të ndërtuar para lufte, kanë ndodhur disa ngjarje, të cilat fqinjëve dhe njerëzve u kanë dhënë arsye që kanë një histori më vete.

TËRË MËHALLA ISHTE NË PANIK!

Pesë kilometra në perëndim të Podujevës, disa vjet, një ngjarje tronditi Llapin e më gjerë!

Shtëpia trekatëshe, në afërsi të aksit rrugor të Podujevës dhe kah kendra e Kacanollit, është bërë vend i

kureshtjes së njerëzve, të cilët ndalen shpesh për të parë vendin ku përflitej se disa herë pas lufte, natën, që nga mbrëmja, shtëpinë e përshkon një kërrhamë njeriu.

Për më shumë, flitet se dëgjohen edhe jehonat e krismave, që vijnë në cilësinë imituese të thyerjes së betonit nën dhe...

Ngjarjet shqetësuese në atë shtëpi, të parët, i kanë hetuar fqinjët. Një fqinj kishte hyrë në shtëpi, duke menduar se aty mund të kishte ndonjë hajn. Dikush thotë se nuk ka asgjë, por e kanë shpikur për t'i frikësuar hajnat. Megjithatë, hajnat nuk kanë çka të vjedhin në atë shtëpi, të cilës i kanë mbetur vetëm muret dhe dyert prej hekuri.

Dhe, derisa dikush ngjarjet i ndërlidhë me hajnat, versioni tjetër se ka diçka në atë shtëpi është më i besueshëm, pasi historikun e ndërtimit të shtëpisë e lidhin me legjenda dhe mitologji popullore.

E para, lokacioni i shtëpisë ishte vend vakëfi, pa pronar.

E dyta, shtëpia është ngritur mbi një bunar. Dikur këndej pari kishin kaluar karvanë tregtarësh që pushonin ditën

e natën. Kishte ujë me bollëk dhe bagëtia pushonte në livadh.

Ç'THONË FQINJËT?

Vendi ku është ndërtuar kjo shtëpi, ka qenë pronë e një burri të quajtur Ukë. Që nga gjyshi i pronarit të tanishëm e deri në vitet nëntëdhjetë, lokacioni i shtëpisë së sotme, që me ngjarje e ka pushtuar Kosovën, ka qenë vakëf, vend i falur për humanitet ndaj kalimtarëve që pushonin ditën e natën.

Dy breza janë kujdesur për bunarin, deri kah viti 1990, kur pasardhësit e Ukës vendosën ta mbyllin bunarin dhe ta fusin brenda rrethojës së oborrit, duke pamundësuar shërbimin me ujë të kalimtarëve.

Dhe, me izolimin e tij, bunari e humbi ujin. Uji humbi dika, e kah askush s'dinte. E, duke parë se e humbi ujin, pronari mori vendim ta mbyllë bunarin.

Me gjasë, dikush ka mallkuar për ujin e zaptuar...

Ndërsa, sipas asaj që shihet tash në dhomat e kësaj shtëpie, ky objekt u shërben për strehë vetëm qenve endacakë...

S. Murturi



Nastradini qante për lopën e ngordhur, politikanët qajnë për postin e humbur!

Populli e do shtetin, Republikën e Kosovës, por liderët e shfrytëzojnë shtetin për qëllimet e veta...

Nastradini e kishte një lopë, nga e cila e mbante familjen me qumësht. Lopa sëmurët dhe ngordh. Ai filloi të qajë, e askush nuk e pajtonte. Për fat të keq, gruaja i kishte vdekur një muaj para se të ngordhte lopa e s'kishte kush as ta ngushëllonte.

Kur i kishte vdekur gruaja, Nastradinin askush nuk e kishte parë duke qarë. Por, kur fqinjët e panë duke qarë për lopën e ngordhur, nga kureshtja e pyetën: "Pse qan për lopën Nastradin, kurse për gruan që të vdiq para një muaji nuk të pa askush duke qarë?"

Nastradini u përgjigjet:

"Kur më vdiq gruaja fqinjët më thanë se kanë me ma gjetur një grua edhe më të mirë dhe nuk kisha arsye të qaja. Por, tash, që më ngordhi lopa, nuk vjen askush t'më thotë se kanë me ma blerë një lopë tjetër!"

E, kështu janë edhe liderët tanë: Qajnë

për mallin e tyre nëse e humbin, e jo edhe për shtetin!

Andej lumit Ibër e kemi një pjesë të Kosovës, në të cilën nuk mbjellim asgjë, por Beogradi mbjell dhe korrë vetë. Pra, shtetin tonë nuk e ruajmë! Nuk e ruajmë, sepse ende jemi nën ndikimin e mentalitetit të mbrapsht dhe naiv se shtetin duhet vjedhur e jo krijuar! Çdo kund në botën e civilizuar garojnë për të marrë poste për t'i shërbyer shtetit e popullit, e te ne garojnë për ta vjedhur shtetin dhe për ta varfëruar popullin!

Ishin dehur dy vetë dhe pas mesnate ktheheshin në shtëpi. Hëna ndriçonte mirë. Njëri që digjej së brendshmi nga rakia i thotë tjetrit:

"Kam vapë nga ky diell që ngrohë shumë!"

Tjetri i thotë:

"Nuk është dielli, por hëna!"

Dhe, njëri dielli e tjetri hëna, u bënë copë... Vjen një pijanec tjetër, e njëri e pyeti:

"Ej, shoki, do të na tregosh a është hëna a dielli ky që ngroh tash?"

Ai ngriti kokën drejt qiellit, vuri dorën mbi vetulla dhe tha:

"Më falni, nuk po e njoh, se nuk jam prej këtij vendi!"

Edhe 22 vjet pasluftë, jemi më të diskriminuarit në Evropë, pa të drejtë të lirë qarkullimi! Ne, viktimat e vitit 1999, për të cilët erdhi këtu NATO, tani po paguajmë çmimin e popullit të dënuar! Andaj, shtrohet pyetja: A jemi aq të këqij sa të mos e gëzojmë atë që e gëzojnë të tjerët?

Nuk di, por di një gjë tjetër: Me ne po befasohen të gjithë! Neve po na qesin kushte e kriteret më të ashpra se të gjithë të tjerëve!

Safet Krivaça



“Njërin binjak ma morën në kufi, tjetrin ma mori Zoti!”

Syla, burrë nga Prizreni, kishte gruan dhe dy djem binjakë. Të voglin ia ndalën paramilitarët në Vërmicë në mars të vitit 1999, kurse tjetri i vdiq para tre vjetësh. Dhe, shkuan binjakët – mbetën lotët...

Syla, tash 75 vjeç, nga Lagjja Arbana e Prizrenit, të dielën që e lamë pas shikonte oborrin e tij të veshur me gjethet e pemëve që kishin rënë në tokë.

Tash, edhe pse kanë kaluar 22 vjet, ai kujton të keqen e njerëzimit, kur njeriu e han njeriun...

Paramilitarët serbë ia ndalën binjakun e vogël, duke e ndarë nga i madhi, në traktorin me tendë najloni gjatë dëbimit për në Shqipëri.

Teksa i pikojnë lotët, Sylës i kujtohen detajet, thuhet ngjarja të kishte ndodhur jo moti... Këtë e lidhë me thënien se nëse njëri binjak ndahet nga tjetri, njëjtë pëson tjetri...

“I ka falë Zoti bashkë. Çka do që i ndodhë njërit, i ndodhë edhe tjetrit”, thotë ai dhe shton: “Zoti ka ditur t’i falë edhe ndaras, por ata kanë lindur bashkë”.

E KEQJA NDODHI NË NATËN ME SHI E VETËTIMË!

“Mot i keq ka qenë. Ka pasur vetëtimë shumë. Shi i madh. Nuk mbaj mend shi më të madh të ketë pasur”, thotë Syla, plaku i përvuajtur nga skamja dhe fati që mbeti

vetëm, pa grua e të dy djemtë binjakë, dritat e vetme të syve që kishte në jetën e vet.

“Pak si vonë i pata, por u rritën shpejt. Por, krisi lufta dhe çdo gjë ndryshoi. Ma dogjën shtëpinë. E dogjën tërë lagjen. U strehuam në ara. Djemtë i mbaja afër vetes, madje më shumë se gruan. I kisha binjakë pas pesëdhjetë vjetësh të jetës sime dhe çdo gjë e shikoja nga këndi i jetës së tyre. Kanë qenë të ngjashëm në fytyrë e trup. Më shumë i kam dalluar përmes zërit sesa pamjes.

Por... Ah, kohë! Ishte kohë lufte. Nuk rrihej ditë e natë në ara. Me traktor u nisëm drejt kufirit, Vërmicës famëkeqe... E tmerrshme ishte nata kur arritëm në Vërmicë... Vetëtimat e shumta natën e bënin ditë...

Në një moment u ndal kolona. Paramilitarët dolën nga kaçubët skaj rrugë dhe u drejtuan te traktori im.

E kapën binjakun tim të vogël për flokë dhe i thanë: “Ti ke me ardhur me ne dhe bashkë kemi me i vra terroristët, UÇK-në!”. Zbrita nga traktori dhe u thashë se djali im është i ri dhe nuk ka qenë në UÇK.

Njëri prej tyre ma vuri thikën në fyt dhe më tha:

“Ne dimë më të thënë edhe ty, por këtë e

kemi parë në UÇK!”.

E tërhoqën për flokësh dhe e zbritën në tokë, në shiun e asaj nate që ishte një gjak në vete. Dola pas tij duke bërëtitur, me ymytin se do ma lirojnë djalin...

I madhi mbeti në qerre dhe u zbehtë i tëri... Djalin e hipën në kamion. Nisi të qante me zë...

Pasi u nis kamioni, njëri prej paramilitarëve më tha: “Hajt plak se ta kthejnë djalin...”

Këtu është Serbi. Këtu ka shtet dhe nuk humb asgjë! Nëse nuk ka qenë në UÇK ta kthejnë...”.

Gruaja qante, si nëna për djalë më... Por, ishte më burrërore se unë... “Bëhet çka ka thënë Zoti!”, tha.

Dolëm në Kukës, me dhimbje të madhe në shpirt...

Prej asaj dite, djali im i vogël, më nuk u gjet kurrë. Eh, sikur t’ia dinim varrin, bile! Dhe, dhimbjet e mia nuk u ndalën me kaq. Dhjetë vjet më parë më vdiq gruaja. Nga mërzia se nga çka tjetër?

E, e keqja tjetër më erdhi para tre vjetësh, ku vdiq edhe binjaku tjetër. Nuk ka qenë i sëmurë. Rrinte i zbehtë në fytyrë, por nuk e dinim pse. Kishte pasur probleme me anemi...”.

Safet Krivaça

Fluturime direkte të sigurta dhe komode drejt Prishtinës dhe Shkupit. Rezervo tani!

Düsseldorf

« Prishtinë

Stuttgart

« Prishtinë

Frankfurt

« Prishtinë

Hannover

« Prishtinë

München

« Prishtinë

Hamburg

« Prishtinë

Zürich

« Prishtinë

Zürich

« Shkup

Basel

« Prishtinë



Easier way **to fly.**

flyksa.com

KOSOVA AIRLINES

eurokoha

KU ËSHTË
UKSHIN
HOTI ?



Cilëve heronj e martirë shqiptarë nuk u dihet varri?

Nga Abdulla Mehmeti, akademik

Asnjë popull në botë nuk ka si ne, shqiptarët, listë shumë të gjatë të heronjve dhe martirëve të tij, që nuk u dihet varri, nga Skënderbeu e deri te Ukshin Hoti.

Listës mund t'i bashkëngjitet emri i secilit prej atyre, shpirti i të cilëve u bë fanar drite ndër shekuj në altarin e lirisë së Atdheut.

Nuk ka mallkim më të madh nga Zoti mbi një popull, i cili bijtë e vet më të denjë i lë në harresë dhe i nderon e lartë-

son të huajt, tradhtarët dhe armiqtë e tij! Lista është tepër e gjatë. Edhe ju mund ta vazhdoni...

Gjergj Fishta

Mehmet Pashë Deralla

Josif Bageri

Shaip Kamberi

Si para 50 vjetësh...



Pse në Opojë ende gartë rrinë mbyllur?

Kosava është një prej fshatrave që konsiderohet ndër më të bukurit në Kosovë. Banorët tregojnë se fshati është ndër më të vjetrit në trevën e Opojës.

Por, në këtë fshat nuk mund të shohësh asnjë grua jashtë shtëpive të tyre. Gratë e këtij fshati e kanë të pamundur të dalin nga shtëpitë dhe të zhvillojnë një jetë normale, shkaku i fanatizmit.

Në këtë fshat është e pamundur të takosh ndonjë grua që të bisedosh me të...

Banorët e këtij fshati thonë se gratë nuk dalin në rrugë, sepse e kanë traditë të mos dalin jashtë shtëpisë.

"Nuk e kemi traditë që gratë të dalin në rrugë. Gratë nuk dalin se kanë marre. Jemi hala në atë kohën e fanatizmit", thotë Bedriu, burrë rreth të shtatëdhjetave.

Lotët e motrës m'i kujtojnë këngët e nizamëve

Motra ka ardhur nga larg, e unë akoma e shoh si dikur, me shami në kokë, madje edhe sytë e saj të përлотur. Më bëhet sikur jemi në natën kur ajo qante që shkonte nuse, e më përqafonte me lot të ngrohtë. I binin lotët mbi qejzin, e që më duket sikur i shoh gjithë ato që pat qëndisur...

Dritarja do të mbulohej me batanije që të mos dukej drita jashtë shtëpisë. Motra qëndiste qejzin e pajës, sepse pak ditë më vonë do të niste të qante nën shami të kuqe, që nuk do ia shihnim sytë e përлотur. Do të vinte herët në mëngjes, tek flija në shtrat, t'më përqafonte e mallëngjyer, e që dy vajza anash do e mbanin për krahësh. Ishte viti i demonstratave të mëdha në Kosovë. Ishte kohë e rëndë për shqiptarët me plis, por ishin të rëndë edhe lotët e motrës që do të bëhej nuse, e që do ta kujtonim nusërinë e saj përjetë, duke pritur shtatë ditët e para të javës për ta parë sërish në shtëpi, kur burrat do vinin për të parën herë me dhëndrin. Dhëndri, sipas zakonit, nuk fliste, vetëm dëgjonte me vëmendje muhabetin që bëhej në odë. Nuk fliste as atëherë kur kush e pyeste diçka, sepse ai mund të gabonte nga turpi, mund t'i merrej goja. Dhe, në vend të tij përgjigjej dikush nga të afërmit. Andaj, do të shkonte shumë kohë që ai të përshtatej me familjen tonë...

E, motra duhej të adaptohej sa më parë te familja e burrit, duke u zgjuar e para, qoftë edhe për t'i shikuar të tjerët si gërhitin në gjumë. Kur të zgjoheshin të tjerët do të duhej të ishte fshirë shtëpia e oborri, do të duhej të ishin bërë punët e mëngjesit...

MBESA IME NUK DI TA DALLOJË DASHNORIN NGA BURRI!

Kanë kaluar shumë e shumë vite. Motra tashmë është plakur. Sa herë vjen e shikoj me kureshtje. Më shkon goja ta pyes: Motër, ku e ke shaminë që e mbaje mbi kokë në ditën që bëheshe nuse? Ku e ke mindilin që dikur i fshije lotët? Ku e ke përqaftimin e ngrohët që ma bëje? Ke tretur si në këngët e nizamëve: përtej shtatë deteve, e unë kam mbetur këtu, në vendin e lotëve të dikurshëm... Më përqafo, të lutem, si në kohën kur ishe me shami në kokë dhe ta kthejmë kohën pas...

Më së miri është ta lëmë një amanet: të varrosemi te varret e luleve, aty ku janë edhe prindërit tanë. Herën e fundit, kur erdhe, erdhe me vajzën tënde. Ishte rritur e bërë grua ajo... Fliste për të dashurin e vet, të cilin herë e quante burrë e herë dashnor. - A është burri a dashnori? - e pyeta. Më tha: - Burri. - A jeni martuar? - Jo, ende. - A jeni fejuar? - Jo, ende. - A ta njehë familja "burrin"? - Jo, ende. - E, si mund të jetë ai burri yt: as nuk ta njehë familja, as nuk ka ndodhur fejesa, as nuk ta ka bërë me dije se do fejoheni? Jo, mbesa ime, burri është burrë vetëm pasi të jepet dora me burra. Pasi të keni bërë dasmë. E, e jotja qenka dashuri dhe asgjë më shumë... Ti ende nuk po e dalloje burrin nga dashnori!

S. Murturi



Ndonëse i ka mbushur 72 vjet, Ibrahim Qerimi ende nuk i ka harruar mësimet që i ka ndjekur dikur në fushën e hotelierisë...

Ibrahim Qerimi, në vitin 1974, në kohën e ish-Jugosllavisë, kishte zënë vendin e parë si kamerieri më i mirë dhe më i shpejtë, ndonëse kishte pjesëmarrës nga Serbia, Vojvodina e Mali i Zi. "Në Pejë kemi qenë rreth 60 apo 70 kamerierë nga Kosova, Serbia, Vojvodina e Mali i Zi. Më ka rënë, së paku, tetë herë në kualifikime për garën e vendit të parë. Dhe, zura vendin e parë", ka thënë ai. Ani pse kishte triumfuar në këtë garë, shkaku i inatit të serbëve, thotë nuk ia kishin dhënë çmimin e artë. Gati gjysmë dekadë ka ush-

Ferizajasi që i bëri kafe Titos, Rugovës e Hashim Thaçit

truar profesionin e kamerierit. Dhe, gjatë kësaj periudhe kishte pasur rastin t'i shërbejë ushqim Titos, madje dy herë. Por, edhe figurave të tjera politike të kohës, duke përfshirë edhe ish-presidentin Ibrahim Rugovë. "Si kamerier i kam shërbyer Titos në vitin 1974, në Hotelin "Jugosllavia" në Beograd, në kohën kur ishte me delegacionin nga Kosova: Mahmut Bakal-

lin, Fadil Hoxhën etj. Pas lufte edhe kryetarin Ibrahim Rugovë e kam shërbyer, së paku, dy herë. Pastaj, edhe të tjerët, Hashim Thaçin e të tjerë", thotë ai.

Radio, Lajme, Moti, Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin **Shkabaj** për Android



www.shkabaj.net

Modele: Dua Lipa

BOOM

Kush e ka tradhtuar
Big Mamën?

Për Xhensilën
qershitë piqen
edhe në vjeshtë!

Pse Bebe Rexha
u mbyllë 3 muaj
në shtëpi?

Për Beatrix Ramosajn
me pi marihuanë
është normale!

Enca,
sa me dashnor,
sa beqare!

DUA LIPA

krenaria e Kosovës



Për Beatrix Ramosajn

*me pi
marihuanë
është
normale!*

Këngëtarja e njohur, Beatrix Ramosaj, është njëra ndër banoret në spektaklin shumë të ndjekur “Big Brother VIP” në Shqipëri. Një nga pyetjet që i janë bërë në këtë shtëpi ishte: “A e ka provuar ndonjëherë marihuanën?”.

Këngëtarja tha haptazi se e ka provuar disa herë, duke qenë se ka lindur në Holandë, vend ku përdorimi i marihuanës është legal.

“E kam provuar. Si mund të mos e provoj një i ri që ka lindur në Holandë?! Madje, sa herë që shkoj te daja pi marihuanë”, tha ajo.

Sa me dashnor, sa beqare!

Këngëtarja e njohur, Enca, është shumë aktive si me projekte muzikore, ashtu dhe në jetën e përditshme...

Shpesh është aluduar për një të dashur zemre, pasi Enca ka publikuar shpesh në "Instastory" foto romantike. Në verë ajo publikoi një foto buzë pishinës, ku dukeshin dy gota shampanjë dhe duart e saj dhe të një dashnori.

Po ashtu, kah fundi i muajit këngëtarja tregoi me anë të disa fotove shtratin e mbushur me petale dhe buqetë me trëndafila rozë në cep të tij.

Ndonëse Enca nuk e konfirmoi kurrë, këto veprime kanë ngritur aludimet për një lidhje të mundshme. Gjithsesi, edhe sikur të ketë qenë, mesa duket, ka marrë fund, sepse ditëve të fundit ajo shkruan: "Beqare, rehat n'shpi tu e dit që s'më tradhton njeri".



DUA LIPA

krenaria e Kosovës

Ajo është absolutisht ylli më me renome në botën e muzikës ndërkombëtare, një "hitmaker" dhe diktuese stili e denjë.

Artisja shqiptare, Dua Lipa, është nderuar me Çmimin e Lidershit në Këshillin Atlantik të Uashingtonit, për karrierën e saj muzikore dhe për angazhimin e saj në kauza filantropike, përfshirë fuqizimin e brezit të ardhshëm të udhëheqësve dhe muzikantëve ballkanikë nëpërmjet fondacionit dhe festivalit "Sunny Hill". Fjalimin e saj në 60-vjetorin e Këshillit Atlantik, e nisi me fjalën shqipe "Mirëmbrema". Artistja u shpreh jashtëzakonisht e lumtur për çmimin, teksa theksoi se ai i dedikohet të rinjve të Kosovës. Përveç që foli për punën dhe planet e saj me "Sunny Hill", Dua ftoi publikisht krerët e Bashkimit Evropian që Kosovën ta bëjnë pjesë të këtij unioni, në mënyrë që edhe shteti ynë të zhvillohet ekonomikisht dhe kulturalisht përkrah vendeve fqinje.

DUA LIPA TREGON FYTYRËN E VËRTETË TË KOSOVËS

Dua, tashmë e shpallur "Artistja e Shquar e Vitit 2021", në këtë ngjarje

ishte e shoqëruar nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. "Qëndroj para jush si një fëmijë i Kosovës, që ka lindur dhe është rritur në Britani të Madhe, që sot jam këtu si një mysafire e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Unë vij nga një vend që shumë nga ju, sigurisht, keni dëgjuar. Por, ndoshta jo në mënyrën se si unë do ta përshkruaj tani. Dua të ndaj më ju pak nga Kosova ime. Kosovarëve u pëlqejnë ndejat, gjë që nuk është për t'u befasuar, ngase rreth 50% e popullatës sonë është nën moshën 25-vjeçare. Zyrtarisht, unë jam e moshuar në Kosovë! Së fundi, kam dëgjuar një rrëfim për një turistë që vizitoi Prishtinën, kryeqytetin e Kosovës, e cila kishte mbetur zgjuar deri vonë nga një turmë njerëzish që po rrinin në një lokal pranë hotelit ku qëndronte ajo. Në mëngjesin e ardhshëm ajo pyeti në recepcion pse u bë gjithë ajo ndejë dhe ata iu përgjigjen - ishte thjesht e HËNE. Prishtina ka një kulturë të mrekulueshme të kafesë. Harrojeni shprehinë që ta merrni kafën me vetë, vishuni bukur, zini një karrige dhe, thjesht, shikojeni botën teksa kalon.

Është shumë evropiane. Për një vend të vogël, Kosova është e mbushur me njerëz kreativë dhe mund të them shumë shembuj, por sot disa prej tyre janë këtu. "Zgjoji", një film me kastë të mrekulueshme, që ka marrë tri çmimet më të mëdha këtë vit në "Sundance Film Festival". Dhe, prisni të shihni suksesin e tij në "Oscars". Prishtina, po ashtu, do të mbajë edhe Manifestin vitin e ardhshëm, që është një festival i kulturës dhe artit kontemporan. Dhe, ne do të mund ta shohim qytetin të mbushur me artin publik, me ekspozita dhe instilacione të ndryshme. Dhe, gazetarë të medieve të mëdha spekulojnë se çfarë mund të ketë në ujin e Kosovës që po nxjerrë kaq shumë artistë të suksesshëm në muzikë. Krejt çka mund të them është na jepni një mundësi dhe ne do të shkëlqejmë. Në vitin 2018, unë dhe babai im, krijuam festivalin "Sunny Hill", në Prishtinë dhe shumë shpejt u bë njëri nga festalet më të mëdha të muzikës në regjion. Ka qenë një ëndërr e kamotshme jona që të sjellim artistë të mëdhenj në

Kosovë, jo vetëm që fansat e tyre të njihen me bendet e mëdha, por që edhe vetë këto bende të përjetojnë muzikën tonë të mrekullueshme dhe të shumëllojshme.

Pjesa e dytë e ëndrrës tonë shumë shpejt do të bëhet realitet dhe unë nuk do të mund të isha kurrë më e ngazëllyer se sot që të ndaj më ju planet për fondacionin "Sunny Hill". Ne kemi nënshkruar një kontratë me kompaninë e njohur MOU, për të krijuar qendrën kreative të "Sunny Hill" në Prishtinë dhe shpresojmë shumë që ajo do të fillojë të funksionojë verën e ardhshme. Do të jetë një hapësirë kreative ku të rinjtë do të mësojnë për industrinë e muzikës dhe për performanca.

Për ata që duan të futen në këtë industri do të ketë punëtori të ndryshme dhe vizita të artistëve dhe producentëve nga gjithë bota, të cilët do të tregojnë atë që kanë mësuar dhe për të tjerët qendra do të jetë një vend ku do të mësojnë të ngritin vetëbesimin, të mësojnë gjëra të reja dhe, më e rëndësishmja, të bëjnë qejf. Koncerti i parë, në të cilin kam shkruar, ishte ai i bendit "Method Man and Redman" në Prishtinë dhe unë isha vetëm 13 vjeçe. Ishte pak e pazakontë, shumë cool dhe, përfundimisht, jo aq i përshtatshëm për moshën time. Por, e vërtetë është se nuk kisha zgjidhje të tjera.

Kosova është një treg i vogël që të bëhet pjesë e turneve të mëdha botërore. Andaj, ne tani do t'i sjellim artistët në Kosovë. Dhe, pa bërë asnjë përjashtim, të gjithë ata që i kemi ftuar për të performuar në festivalin "Sunny Hill", duke filluar nga Miley Cyrus, e deri tek Clavin Harris, të cilët janë mrekulluar me gjithë eksperiencën. Ata kanë deklaruar se eksperiencia në Kosovë ka qenë ndër më të mirat, duke qenë se energjia ka qenë shumë e mirë, audiencia shumë e zëshme dhe mikpritja ishte shumë e ngrohtë.

Performuesit më të mirë thonë se shou që kanë këtë lloj energjie të mrekullueshme, janë më të mirë. Dhe, disi, kjo gjithmonë ndodh në "Sunny Hill". Sidoqoftë, pamja mund edhe të mashtrrojë, në shumë mënyra jeta në Kosovë është e vështirë. Dhe, në mënyrë të pamohueshme bartë plagë të luftës. Edhe për ata që arriten

t'i iknin luftës. Prindërit e mi u larguan nga Kosova në vitin 1992, në kohën kur situata po tensionohej dhe, për fat të mirë, ne arritëm të krijojmë një jetë të mirë në Londër.

Kishte vite të tëra që ata e dinin se nuk mund të ktheheshin në shtëpi, e kjo, sigurisht, u ka shkaktuar shumë dhimbje, aq sa ne mund vetëm ta imagjinojmë.

Ndonjëherë, kur flas me prindërit e mi për atë kohë, mund të flasim për këtë temë me orë të tëra. Dhe, nganjëherë, thonë se e kanë ndjenjën sikur kanë 300 vjet jetë! Për mua, të kem këtë identitet të dyfishtë, realisht, ka qenë shumë pozitiv, jam gjithmonë e përkëdhelur me komentet e njerëzve, duke më thirrur në atë që ata e quajnë etika e punës së një emigranteje dhe është e vërtetë, është një dhunti që është bartur nga brezi në brez për gjenerata të shumta.

Por, edhe përkundër vendosmërisë dhe shpirti luftarak, duhet kohë për t'u shëruar dhe për të nisur gjithçka nga fillimi.

Sot, Kosova, vazhdon edhe më tej të ballafaqohet me shumë sfida dhe janë pikërisht brezat e rinj ata të cilët i vuajnë pasojat. Të rinjtë luftojnë për të gjetur punë dhe mundësitë e tyre pengohen nga kufizimet që e bëjnë të vështirë udhëtimin për punë ose kënaqësi. Pasi kemi përmbushur të gjitha kriteret, Komisioni Evropian, në fakt, ka rekomanduar liberalizimin e vizave për Kosovën për më shumë se tre vjet më parë.

Pra, a mendoni se ne mund ta arrijmë atë tani?! Kosova është edhe shteti më i ri në Evropë, në një mënyrë tjetër. Janë vetëm 13 vjet të shkurtra në rrugëtimin tonë të pavarësisë. Dhe, si pjesë e një komuniteti të fortë ndërkombëtar, ne do të lulëzojmë emocionalisht. Ne do të lulëzojmë edhe ekonomikisht e kulturalisht. Është në gjenet tona.

A nuk do të ishte e përshtatshme nëse Kosova mund të zinte vendin e saj brenda atij bashkimi paqësor, të lulëzonte ekonomikisht përkrah fqinjëve tanë dhe të shëronte lëndimin e konfliktit të fundit? Me këtë vizion, unë e pranoj këtë çmim, me mirënjohje për të gjithë të rinjtë e Kosovës", kështu u shprehë Dua Lipa, në Këshillin Atlantik.



Pse Bebe Rexha u mbyllë 3 muaj në shtëpi?

Këngëtarja e njohur me orgjinë shqiptare, Bebe Rexha, nuk e ka pasur aspak kompleks që të hapet për problemet e shëndetit mendor, përballjet me ankthin dhe periudhat e errëta në jetën e saj...

Ndër të tjera, ajo ka rrëfyer se si i ka ardhur frymëzimi për hitin global "Monster".

"U mbylla në shtëpi tre muaj. Nuk pranoja të largohesha. Babai vinte në dhomën time të gjumit, më kapte dorën dhe më thoshte: "Le të dalim pak", duke më marr me zor të shkoja në shëtitje me të.

Më kujtohet rruga që bënim. Unë i jam mirënjohëse babait për shumë gjëra, por e vetmja gjë për të cilën jam gjithmonë falënderuese për të është se në atë kohë, kur isha në errësirën time dhe motivimin më të ulët, ai, thjesht, më kapte dorën dhe më ftonte të dilnim bashkë. Ne ndalojmë së kërkuari përbindëshat që janë nën shtrat kur kuptojmë se janë brenda nesh. Nga ky edhe lindi frymëzimi për krijimin e hitit global "The Monster", thotë ajo.

Për Xhensilën

*qershitë piqen
edhe në vjeshtë!*

Këngëtarja e dashur për publikun, Xhensila Myrtezaj, është e këndshme. Jeta e Xhensilës është me shumë skena. Ka shije për veshje, ka shije për çdo stinë, por ka shije edhe për çdo çast të bukur të jetës... Rrjeti është një mundësi e mirë për të dëshmuar se edhe në vjeshtë çelin qershitë, se edhe në vjeshtë piqet fiku, se edhe në vjeshtë manaferrat janë të ëmbla dhe me shumë lëng...





*Kush e ka tradhtuar **Big Mamën**?*

Këngëtarja, Big Mama, ka pranuar se është tradhtuar, por nuk ka qenë problem për të. Ajo theksoi se “i dhemb tradhtia”, por nuk do e prishte lidhjen apo familjen nëse burri do bënte seks një natë me një femër, duke shtuar se “nuk do hajë vetëm fasule”.

“Po, jam tradhtuar. Ka shumë lloje tradhtish. Nuk më vret, të them të drejtën, s’e kam atë problem. S’jam si femrat e tjera që bëhen hysterike dhe xhelozë të mëdha.

Më dhemb kur s’ka xhelozë, s’ka dashuri. Por, nuk prishet një lidhje ose familja nëse burri

apo i dashuri ka dalë një natë me një femër. Punë e madhe, ka shkuar një natë, pastaj ka ardhur te unë. U mashtrua. Natë për natë fasule nuk hahet! Përderisa më respekton e vlerëson, jam primare për atë, nëse del ndonjëherë shinave, hallall e ka”, shprehet Big Mama.



KOMPLEKSI ULPIANA CENTER



KOMPLEKSI ELIZA FUSHË KOSOVË



Pse i lashë fëmijët e burrin për ish-dashnorin?

“Nuk di a kam pasur mend në kokë atëherë. Nuk di saktësisht se çfarë synimi kisha ato ditë të tmerrshme bashkëshortore e jetësore, apo dëshiroja ta mbaja fjalën e dhënë ish-dashnorit se herë do kur do i kthehem...”

Ajo që më ndodhi mua, tani që jetoj e vetme në Gjilan, nuk besoj se do të ketë përjetuar kush tjetër. Nga ana tjetër, them se ndoshta atëherë nuk isha as në mend mirë, ndërsaq sot mendoj ndryshe: do e kisha merituar një dënim të rëndë.

S'MUND TË JEM E LUMTUR ME ASNJË MASHKULL!

Unë s'mund të jem më e lumtur me asnjë mashkull dhe s'mund të kem më fëmijë, meqë ata që i desha, i humba njëherë e përgjithmonë.

Unë isha ajo, nëna e tyre, që me vetë-dëshirë ua ktheva shpinën, vetëm e vetëm që t'i kthehesha ish-dashnorit, e që ia pata dhënë fjalën se herë do kur do të jemi bashkë...

Tashmë jam një e shkallmuar. Dhe, si të mos jem, kur e shkatërova bashkëshortësinë me të gjitha të mirat, ndërsaq humba burrin, Arlindin dhe Jehonën, si dhe më përzunë nga shtëpia edhe prindërit e mi.

Thjesht, humba gjithçka, madje edhe ish-të dashurin tim, i cili pas dy vjet jetë bashkë, ma ktheu shpinën, sepse nuk mund t'më

duronte duke qarë tërë ditën për fëmijët që i lashë.

PO E NDJEJ MUNGESËN E NJË MASHKULLI, POR JAM PA SHPIRT!

Më duhet ta pranoj se në këto kohë të vështira që po i kaloj, po e ndjej mungesën e një mashkulli, por nuk mund të dalë me asnjërin që më vardiset, meqë mendja e shpirti më kanë mbetur te fëmijët që i lashë në fillim të jetës së tyre. E, ndoshta, Zoti do më dënoj edhe më rëndë se që jam tash...

M. A.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimi 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimi gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimi tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimi.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimi Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qullët trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Si mu shkatërrua martesë shkak i dhunimit?

“Kam pasur dy vjet martesë, kur jeta ime mori tatëpjetën”, shprehet D. S., nga një fshat i afërt i Prishtinës, për të vazhduar: “Kam dashur të bëhem e singertë para burrit, të mos fsheh asgjë që më ka ndodhur... Por, pësova keq!”.



“Bashkëshorti im ndodhej në lagjen “Taslixhe” të Prishtinës, te një i afërm i tij, me qëllim që të dilte jashtë Kosovës po të kishte mundësi. Unë mbeta në Mramor me kunatën e mitur (motra e burrit), si dhe me dy gra kushërija të burrit. Nga frika rrinim bashkë... Të dy gratë dolën nga shtëpia ku qëndronim dhe qëllimi i tyre ishte të kërkonin vend më të sigurt. Pas shkuarjes së tyre ankthi e frika m'u shtua edhe më shumë, sepse mbeta vetëm me kunatën e mitur... Thosha: mirë që burri bile nuk është këtu, sepse çdo ditë e më shumë shihej se siguria në këtë vend sa vinte e keqësohej. Kur filloi ofensiva në Mramor, turma ku ndodhesha unë e kunata ime e mitur, ia mësymë Llukarit, me qëllim që të arrinim, pastaj, në Prishtinë. Teksa me kuantin arritëm te vendi “Tuneli”, para nesh është ndalur vetura e mbushur me paramilitarë. Kanë dashur të na vrasin menjëherë, sepse ishin revoltuar nga bombardimet e njëpasnjëshme të NATO-s. Njëri prej tyre na ka futur në veturën e tyre dhe na kanë detyruar të ulemi në prehër të tyre. Na kanë ngacmuar e prekur kudo

nëpër trup...

Pa ecur as dhjetë minuta vetura është ndalur. Mua më kanë nxjerr nga vetura dhe më kanë dërguar në një shtëpi, në të djathtë të rrugës. Ndërkaq, kunatën e mitur e mbajtën në veturë edhe më tutje...

Në atë shtëpi pa njeri, më kanë mbajtur nja dy orë duke më dhunuar njëri prej paramilitarëve.

Ai, kur lodhej, më ka pyetur se a ka pasur në Mramor UÇK.

E kam lutur të më lëshonte e të shkoja në Prishtinë. Më tha: “Ku e ke burrin? A e ke burrin në UÇK?”.

I kam thënë nuk jam e martuar. Nuk kam burrë.

“E, ku e ke shtëpinë në Prishtinë. Të dërgoj unë në shtëpi”, më tha.

Në ato çaste erdhi një tjetër paramilitar dhe ia bëri me kokë që të më lëshoj. Ai, në fillim hezitoi, por pas pak më tha: “Ec, zhdukul!”.

“Po, por ma jepni motrën e mitër që ishte me mua”, u thash.

Kur arritëm te vetura, ia hapën derën kunatës sime të mitur dhe ajo u bashkua me mua.

Pasi na liruan ia kemi mësyre Prishtinës. Kur arritëm në hyrje të Prishtinës,

jemi vendosur në një shtëpi boshe në rendin e dytë të shtëpive, afër hekurudhës.

Tërë rrugën kunata e mitur më ka pyetur në mos më kanë çnderuar. Por, asnjë fjalë të vërtetë nuk ia thash. I thash se më kanë marrë në pyetje rrafsh dy orë, më thanë ku e kam burrin, pse nuk është burri me mua, e të tjera të ngjashme...

Të nesërmen, kah mesdita, kam pasur abortim spontan. Kam pas shumë dhimbje në bark...

Pas hyrjes së trupave të NATO-s, kur jam bërë bashkë me bashkëshortin, i kam treguar menjëherë se çka ka ndodhur me mua në kohën teksa kthehesha nga Mramori për në Prishtinë, me shpresë se ai do më kuptoj dhe do më ndihmoj ta tejkaloj dhembjen që e kisha në shpirt.

Por, ndodhi e kundërta. Pas pak ditësh ai më tha se më nuk jam gruaja e tij. U solla e u pështolla, mblodha rraquet dhe u ktheva në shtëpinë e prindërve, në fshatin tim të lindjes, në afërsi të Prishtinës, tregon D. S., në kohën kur e bëmë këtë bisedë, në vitin 2003, në një lokal të Prishtinës.

S. M.



ALAYAH
LUXURY STYLE



Erdhi të banojë me qira, u bë dashnorja e tij

“Lëshoj një dhomë me qira në Qendër”, dhashë në internet shpalljen. Më thirrën disa vetë, por edhe një femër. Ajo tha se më përgjigjet edhe çmimi edhe vendi. Ok, i thash, eja e shihe dhomën”.

Nuk e dija kush ishte ajo që lehtë pranoi nëpërmjet telefonit se do të vendosej në dhomën e banesës sonë, të cilën bashkë me grua vendosëm ta lëshojmë me qira, që ta zbusim sado pak gjendjen tonë të rënduar ekonomike.

Dhe, ndodhi ajo që ndodhi. Më duhej ta bindja gruan se në banesën tonë tash do e kemi edhe një studente banuese dhe nga ajo do i merrnin 150 euro në muaj. E, ne do të sillëshim ftohtë me të, madje krejt indiferent... Por, nuk rodhan të gjitha ashtu si i parashikoja. Sepse, më vonë, unë, si gazdë, më ra të flija disa herë me të, në të njëjtin shtrat ku flinte gruaja ime...

STUDENTJA NGA KLINA, BIJË BIZNESMENI

Ishte bijë biznesmeni dhe kjo shihej edhe në pamjen e saj, në veshjen e saj bukur, në mbajtjen e higjienës etj.

Në fillim çdo gjë ka shkuar siç e kërkonte fillimi. Nuk dialogonim me të dhe as nuk ndnim ndonjë interes të veçantë të hapeshim me njëri-tjetrin. Gjithë ato ditë të para kishim vetëm përshëndetje të ftohta, takim rasti në korridorin e banesës ose në derë të banjës.

Nuk kishim asnjë vërejtje me të, sepse ishte e qetë, e edukuar mirë. Shkurt: ishim të kënaqur me të.

Por, edhe gruaja tregonte njëfarë mirësjelljeje me të, por nuk e zgjaste bisedën me të shumë. Megjithatë, pika e dobët isha unë. Disi, që në shikim të parë më bëri për vete... Andaj, duhej të kisha kujdes që gruaja të mos hetonte gjë.

FRIKËSOHESHA T'IA NISJA I PARI!

“Një të shtunë nuk kishte shkuar në Klinë, siç bënte të shtunave të tjera. Na tha se ishte e gëzuar se kishte dhënë provimin e parë semestral. Do të thotë, sa u përket provimeve, e kishte bërë sefte. Për atë gëzim që kishte na tha se dëshironte të pinim kafe bashkë, në kuzhinën tonë, të cilën e shfrytëzonte edhe ajo.

Fustani i saj i kuq, as që ia mbulonte gjunjët. Dhe, dashur e pa dashur e shikoja eksitueshëm.

Por, nuk doja të zbulohesha nga gruaja, meqë me grua kalonim mirë, madje më shumë se mirë.

E DIELA E PAHARRUESHME...

Të nesërmen gruaja shkoi në familjen e saj, në Kaçanik. Dhe, atje do rrinte, së paku, një natë.

Në mbrëmje, teksa mora në frigorifer një

lëng, ajo doli nga dhoma e saj. Kur më pa, më tha:

“Vetëm je?”

“Po, vetëm, sepse gruaja ka shkuar në Kaçanik”, i thash.

Në çast, biseda u shkëput dhe treta si një hut pa orientim. Por, ajo i dha kuptim atij momenti, duke më thënë:

“Hë, do një kafe nga dora ime?”

“Jo vetëm sot, por gjithmonë”, s’di si më erdhi në gojë.

Gjatë pirjes së kafes më tregoi se ishte e fejuar që në bankat e shkollës së mesme.

Por, i fejuari i saj ishte në Gjermani dhe kishte 9 muaj që nuk e kishte parë.

Dhe, këmbët i ndërronte sa në njërin e sa në tjetrën.

Ah, thash me vete, kjo qe nëntë muaj qenka pa mashkull!

Ndërkohë, kur i dha të ngrihej, që t’i largonte filxhanët e kafes nga tavolina, unë, për habi, m’u errësuan sytë dhe ia ngjita për dore, edhe pse frikësohesha se do të reagoje.

Kur shkuam në dhomën time, në të cilën bëja gjumë me gruan, më tha:

“A të ka shkuar ndonjëherë në mendje se do të ndodhë kjo që po ndodh tash?”

“Jo vetëm që më ka shkuar, por qe sa muaj ëndërroj për këtë çast”, i thash, duke m’u dridhur zëri.

Y. M.



*Sukseset e Helfer
s'kanë mbarim!*



Dikush s'lë gjë pa bërë dhe prapë e virgjër!

Në shumicën e rasteve vajzat shqiptare humbjen e virgjërisë e marrin si kërkesë apo dëshirë të të dashurit, e jo si dëshirë e tyre. Konkretisht, çka mendojnë të anketuarat tona në këtë temë?

**MELIZA, KONTABILISTE, 23 VJEÇE:
DIKUR PËR VIRGJËRI VRITESHIN. E TASH?**

- Dikur, jo edhe në kohë shumë të largët, virgjëria ka pasur rol shumë më të rëndësishëm sesa tash. Ndërkaq, unë mendoj ndryshe. Ta dashurosh dikë do të thotë ta pranosh ashtu si është: e virgjër apo me përvojë dashurie.

Për mua nuk është vendimtare virgjëria në dashuri. Më shumë virgjërinë mund ta shfrytëzojnë ato vajza që nuk janë të sigurta se i dashuri i tyre i do, vërtet. Mendoj se nëse dikush të do, vërtet, nuk të pyet sa të dashur i ke pasur para tij, por mundohet të të bindë se të do dhe me ty do e kalojë jetën. Por, në ditët tona ka edhe mashtrime. Në fillim djali paraqitet shumë tolerant, thajse nuk i intereson fare je apo nuk je e virgjër, e më vonë, kur të të bën për vete, e ndërron traken dhe pyet edhe për ato gjëra që as që të kanë shkuar në mend ndonjëherë...

**ERA, 21 VJEÇE,
MOTËR MJEKËSORE:
DIKUSH S'LË GJË PA
BËRË DHE PRAPË ËSHTË
E VIRGJËR!**

- Unë njoh dy shoqe pune, të cilat s'kanë lënë gjë pa bërë, ndërkaq të dyja janë martuar vitin e shkuar, madje u kanë thënë të dashurve të tyre se janë plotë-

sisht të virgjëra.

Nuk di, kam dëgjuar se mund të jesh me një djalë në shtrat dhe prapë je e virgjër!

**VENITA, 26 VJEÇE,
PSIKOLOGE:
DISA DJEMVE U KA
HUMBUR RRUGA
N'OBORR!**

- Pavarësisht se jetojmë në shekullin XXI dhe numri i vajzave të virgjëra po zvogëlohet dita më ditë, unë i uroj të gjitha ato që kanë arritur të shkojnë në martesë të virgjëra.

Sepse, kjo vlen edhe për djemtë. I ndërrojnë nga disa vajza para martesë dhe gruan e duan të virgjër! E, kjo është një dyfytirësi e madhe e tyre...

Si ta përmbyllim këtë shkrim?

Në fund të fundit, i takon vetëm vajzës dhe askujt tjetër të vendosë për virgjërinë e saj a jo... Ajo vetë duhet të vendosë se kur është koha për të humbur virgjërinë...

Diturie Haxhaj



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Janë 14 arsye për të dashuruar një grua që lexon. Cilat janë ato?

ËSHTË INTELIGJENTE

Sa më shumë libra të lexojë, aq më shumë ajo di për botën. Plus, ajo i jep mendjes së saj çdo ditë stërvitje të mirë, e cila ndihmon për ta mbajtur atë të mprehtë. Leximi i vazhdueshëm është i njohur, gjithashtu, për të përmirësuar fjalorin dhe aftësitë e të shkruarit.

ËSHTË KURIOZE

Ajo është kurioze për botën, njerëzit dhe gjërat në të. Gratë që lexojnë, zakonisht, do të kenë një koleksion librash me tema të ndryshme dhe mezi dëshirojnë të mësojnë gjëra të reja.

ËSHTË PARTNER I SHKËLQYESHËM I FAKTEVE DHE NJOHURIVE

Teksa lexon, ajo do të mbledhë fakte, shumë prej tyre plotësisht të rastësishme. Një zonjë e tillë është një partnere e shkëlqyeshme, kështu që do ndiheni mirë ta merrni në lokalin tuaj të preferuar bashkë me miqtë tuaj.

KËNAQET ME PAK

Ajo është mësuar të kënaqet me një kafe dhe një libër të mirë, kështu që ajo di se si, thjesht, të qetësohet dhe të pushojë.

ËSHTË EKSPERTE NË BASHKËBISEDIM

Ndërsa shumë gra që lexojnë konsiderohen të rezervuara, kjo nuk do të thotë se ato nuk kanë biseda të shkëlqyera. Meqenëse

Pse duhet ta dashurojmë gruan që lexon?

ajo di shumë nga leximi i librave dhe re-vistave, ajo ndoshta do të ketë mjaft tema për të folur dhe mund të gjejë mënyra për t'u lidhur me ato që po thoni. Dhe, ndërsa ajo është mësuar të heshtë dhe të marrë informacion, me siguri, do të jetë një dëgjuese e shkëlqyeshme gjithashtu.

ËSHTË SHUMË INTIME

Leximi në vetvete është një veprim intim. Një grua që lexon libra di se si t'i kushtojë vëmendje të plotë asaj që është përpara saj dhe t'i largojë të gjitha hutimet. Kjo aftësi mund ta mbajë në momentet tuaja më intime, ku ajo është e detyruar t'ju japë gjithë vëmendjen dhe dashurinë e saj.

KA IMAGJINATË TË MADHE

Ndërsa lexon, ajo vazhdimisht imagjinon personazhe, ngjyra dhe skenarë. Një grua me një imagjinatë të fortë ka tendencë të jetë shumë më argëtuese dhe e mirë për të dalë me ide për ngjarje të veçanta.

ËSHTË ORATORE SHUMË E MIRË

Meqenëse leximi përmirëson fjalorin dhe i ndihmon lexuesit të kuptojnë më mirë rrjedhën e fjalive, zonja që lexon flet më mirë. Ajo, me siguri, do t'u bëjë përshtypje prindërve dhe miqve tuaj me inteligjencën.

ËSHTË SHUMË AMBICIOZE

Duhet pak ambicie të marrësh një libër dhe ta ndjekësh leximin e tij. Ajo e shtyn veten

të vazhdojë të lexojë edhe kur libri bëhet i vështirë ose ka mbi 200 faqe.

KËNAQET ME TË QENIT VETËM

Pëlqen të jetë vetëm me një libër të mirë dhe nuk do që të shqetësohet pasi të jetë në zonën e leximit. Një grua që mund të jetë e vetme bën një partner të shkëlqyeshëm, sepse nuk do të jetë e varur nga ai.

KA MENDIM KRITIK

Është treguar se njerëzit që lexojnë kanë aftësi më të forta analitike. Pra, ajo do të jetë një person i shkëlqyeshëm për të biseduar rreth vendimeve të vështira dhe planeve të jetës.

ARGËTOHET LEHTË

Gratë që lexojnë, lehtë mund të kalojnë orë të tëra nën një pemë me libër në dorë. Nuk do të duhet ta merrni atë në takime të shtrenjta dhe udhëtime luksoze për të bërë përshtypje të saj.

ËSHTË DËGJUESE E MAHNITSHME

Ajo është mësuar të përqendrohet në tregimet e saj, e cila nuk kërkon aspak biseda. Kjo do ta bëjë atë një dëgjuese të mirë, pasi merr informacion dhe i përpunon pa u përgjigjur ndërsa lexon librat e saj.

U FRYMËZON TË LEXONI

Nëse nuk jeni lexues, me siguri, do të frymëzoheni të merrni një libër nëse e takoni. Ajo duket aq e lumtur dhe e frymëzuar gjatë leximit sa do t'u bëjë të dëshironi të bëni të njëjtën gjë.



Cilat shenja të Horoskopit u bëjnë të vuani në dashuri?

Sa herë i keni premtuar vetes që kjo ishte e fundit, që s'do të lejoni më askënd t'u bëjë të vuajë për dashuri? Ndoshta shumë shpesh, po aq sa numri i herëve ku e gjeni veten duke qarë në ndonjë cep të shtëpisë ose në prehrin e mikes së ngushtë. Nuk ka "të mirë" e "të këqij" në një marrëdhënie, por partnerët e lindur në shenjat e mëposhtme janë më të predispozuar t'u bëjnë të vuani.

UJORI

Të lindurit në shenjën e Ujorit njihen për natyrën e tyre të izoluar, që herë pas herë mund të interpretohet edhe si antisociale dhe, pikërisht, nevoja për të mos i ndarë gjërat e tyre me partnerin a partneren. Nuk jeni në gjendje të balanconi emocionin me arsyen. Ujori nuk mund të krijojë një marrëdhënie të qëndrueshme, sepse është një person i lirë, që i jep përparësi dëshirave të tij.

BRICJAPI

Në pamje të parë, duket se Bricjapi ka çdo gjë për të bërë të lumtur njeriun që ka në krah, por ja që të lindurit në këtë shenjë mund të shkaktojnë shumë vuajtje në çift. Duke qenë se i shohin gjërat gjithmonë nën llupën e llogarive dhe përfitimeve, Bricjapit nuk i kushton asgjë t'i thyejë zemrën partnerit a partneres, në rast se nuk përmbushin kërkesat e tyre. Kokëfortësia dhe ftohtësia janë karakteristika që dallojnë personalitetin e kësaj shenje.

AKREPI

Akrepi përpiqet shumë që marrëdhënia e tij të funksionojë, por edhe vetë e di që nuk është i prerë për një lidhje monogame. Ai është aq pasionant dhe dëshiron të ketë sa më shumë eksperiencë, çka i shkakton vuajtje partnerit a partneres për shkak të paqëndrueshmërisë së tyre.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Një, do e eliminonte keqbërjen;

Dy, do e thyente te ti dyshimin se ke magji, sepse dyshimi në këtë rast krijon problemin që pamundëson shtatzëninë, meqë jep stres e frikë.

Unë shoh se do të kesh fëmijë...

KU E KAM FATIN?

Përshëndetje zonja magjistare, jam 30-vjeçare, nga Gjilani. Dua të di ku e kam fatin dhe kur do të martohem? Kur do më paraqitet ai dhe ku do të jetoj me të: në Kosovë apo jashtë?

“Ada”

Përgjigje:

Martesa jote do të jetë vitin e ardhshëm dhe ti do të jetosh në Zvicër. Megjithatë, do ketë mundësi të përjetosh probleme, të cilat do të kenë të bëjnë me një lidhje të mëparshme që ke pasur, sepse burri yt shoh se ka mundësi të jetë në lidhje ndërfamiljare me të...

A do të kem fëmijë dhe kur?

Përshëndetje e nderuar, jam e martuar qe 4 vjet, por ende nuk kam fëmijë. Dyshimi im është se kam

magji. Te mjeku i kam bërë të gjitha analizat dhe kontrollet dhe të gjitha më kanë dalë mirë, si mua ashtu edhe burrit.

Të lutem, më kthe përgjigje, sepse dua të di se a do të kem fëmijë...

“Nita”

Përgjigje:

Në rastin tënd përjashtohen defektet e natyrës mjekësore dhe kjo është e mira e së mirës. Nuk keni saktësuar nëse e keni edhe ciklin mujor në rregull, apo nëse keni probleme të tjera, e që janë bazë e shtatzënisë. Unë nuk po e përjashtoj mundësinë e ndonjë gjëje dytësore që është pengesë për shtatzëni. Por, ajo çka mund të thuhet është se baza jote për shtatzëni është në rregull. Por, meqenëse shtatzëni nuk ke akoma, është mirë të shkosh me terapi të besimit, e cila do t'i bënte dy gjëra:

Pse vëllai është ftohur nga familja?

Përshëndetje, jemi një familje nga Peja, e lexojmë rubrikën tënde shumë. Halli ynë është se e kemi një vëlla në Gjermani, por familjen e ka këtu. Ai është shumë i ftohet me familje, por edhe me fëmijë e grua. Rrallë fol me fëmijët e vet, e edhe më rrallë me grua dhe me ne!

Kemi besim se do na e tregosh të vërtetën: A ka magji? Të lutemi, mos i publiko emrat!

“Familja e brengosur” Përgjigje:

Nuk është punë magjie, por është punë martese ku ai jeton, në Gjermani. Vëllai juaj ka atje grua dhe ju për afërsisht e dini, por e di edhe gruaja e tij...

Duhet të mësoheni me të vërtetën e tij...

Edhe gruaja, gjithashtu, duhet ta di të vërtetën, në

mënyrë që të mos ketë arsye t'u akuzojë se i keni bërë hile që nuk i keni treguar se burri i saj është i martuar edhe atje.

A do jem e lumtur pasi u riktheva te burri?

Jam nga Prizreni. Kam qenë 10 vjet e martuar, por jam ndarë nga burri që një vit e gjysmë. Por, tash jemi bashkuar sërish... Si e sheh të ardhmen tonë dhe a do të jemi të lumtur?

“Venera”

Përgjigje:

Ju jeni po ata që keni qenë... E dini pse jeni ndarë dhe ajo nuk jep mjaftueshëm shpresë se do të keni perspektivë. Do të jeni bashkë një vit dhe sërish do të ndaheni, pastaj sërish do të bashkoheni, ashtu sikur që nuk është ndarja e parë, por e treta... Dhe, për të treguar më saktë këtë problem, po e marr një shembull: Një i varfër kërkon nga fallxhiu t'i tregojë se si do e ketë të ardhmen... Fallxhiu i tha se do të jetë i varfër edhe vitin tjetër... “E pas atij viti?”, e pyeti i varfëri. “Pas atij viti më mirë po del puna!”, ia ktheu ai. “Hë, çka?!”, foli i varfër. “Nuk do i kesh punët hiç më mirë, por do të mësohesh

me varfri. E, kur të mësohesh me të nuk do të të pengojë shumë”, i përgjigjet fallxhiu.

Nuk kam fat në asnjë punë!

Pse nuk kam fat në asnjë punë që fillohet, por diskush tjetër e shfrytëzon fatin tim? Nga kush po më vjen e gjithë kjo? Shumë hoxhallarë më kanë thënë se të gjitha fatet, si në dashuri ashtu edhe në jetën financiare, i kam të bllokuara... A mund t'më ndihmoni, të lutem!

“Siami”

Përgjigje:

Fatin e askujt askush nuk mund ta merr, pos në ndonjë proces të përzier, ku gjërat duken të ngatërruara. Unë nuk di se çka të kanë thënë të tjerët, por, shembull, fatin e jetës mund ta humbasësh nëse atë që e dashuron e njofton me shokët që janë të pabesë... Nuk shoh se po ta marrin fatin, por shoh se nuk po di ta menaxhosh fatin tënd në asnjë fushë të jetës, prandaj edhe mos-menaxhimi i duhur shkakton probleme të natyrës që po i përjeton ti...

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Kemi gjëra të dyshimta në shtëpi!

Jam një zonjë, 48-vjeçare, kam frikë se më kanë bërë magji, sepse kam gjetur shumë gjëra të këqija dhe prej atij momenti nuk jam mirë... Sëmurem shpesh... A kam magji?

“T. R.”

Përgjigje:

Vetë fakti se keni gjetur gjëra të dyshimta në shtëpi apo kudo që i keni gjetur, mund të jetë një problem në vete se diçka nuk është në rregull me juve dhe se dikush të ka në sy për të të bërë keq. Megjithatë, ju duhet ta hiqni dilemën te mjeku, duke bërë analiza laboratorike dhe duke folur edhe me psikiatrin. Duhet të dini, para së gjithash, a jeni për mjek a jo... Prandaj, sugjerimi im është: së pari bëni analiza se a jeni mirë me shëndet a jo... E, nëse jeni në rregull me shëndet, atëherë duhet të merreni me atë se a u kanë bërë magji a jo...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

Feel the Legend

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
PRIZE HOTEL**
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr

